

Ljubinka Radenković, NARODNE BASNE I BAJANJA, Niš 1982.

*Yshtjet dhe namatisjet popullore* të Lubinko Radenkovićit, në botim të botuesve të bashkuar (Niš 1982), libër ky voluminoz dhe i rëndësishëm i një lloji krijimesh popullore të të folurit, është fryt i punës shumëvjeçare të këtij hulumtuesi të ri. Lënda në gjuhën serbokroate është mbledhur me kujdes dhe janë zgjedhur shembujt më tipikë dhe më të mirë. Ne deri më sot nuk kemi pasur ndonjë libër të këtillë të namatisjeve ose të ushtjeve siç i quan redaktori i botimit, e ato janë të rralla edhe në literaturën botërore, si për nga vëllimi dhe numri i shembujve, ashtu edhe për nga llojlojshmëria, begatia dhe bukuria e shembujve. Në libër janë dhënë vetëm disa shembuj në gjuhën maqedonase „si ilustrim” nga thesari i pasur i krijimtarisë gojore maqedonase.

Radenković i e ka komponuar librin për mrekulli. Së pari i ka dhënë *Vërejtjet* (fq. 5—6), pastaj studimin mbi këtë lloj të krijimeve popullore të të folurit *Vendi dhe rëndësia e namatisjeve popullore në kulturën tradicionale* (fq. 7—26); teksti i namatisjeve zë më shumti vend (fq. 27—382); *Vërejtjet dhe komentet* janë në fq. 383—436; pastaj është dhënë *Bibliografia e namatisjeve popullore* (fq. 437—473), mandej *Fjalori i fjalëve më pak të njohura* (fq. 425—487). Regjistri alfabetik (fq. 489—519) dhe në fund janë rezymetë në gjuhën angleze (fq. 521—522) dhe në gjuhën ruse (fq. 523—524). Kështu, libri i namatisjeve është pajisur me aparatit e nevojshëm shkencor, me hulumtuesit e domosdoshëm, por gjithashtu të dobishëm për çdo lexues.

Në *vërejtjet hyrëse* janë dhënë shënimet themelore mbi librin, vëllimin prej më se njëmijë tekstesh të kontrolluara të përmbledhjeve të namatisjeve, prej të cilave në libër janë dhënë 630 shembuj, që vërtet i japin mundësi lexuesit të ketë një pasqyrë të plotë mbi këtë lloj krijimesh popullore të të folurit në gjuhën serbokroate. Të gjithë shembujt janë dhënë në libër në formën autentike, kurse autori u ka dhënë formën e vargut dhe ka shënuar emrat e personave ku ka qenë e nevojshme të tek-

stet që kanë qenë në formë të të folurit të lirë.

Në studimin e gjerë mbi namatisjen popullore në traditën tonë të kulturës gojore Radenković ka sqaruar vendin dhe kuptimin e këtij lloji të krijimeve popullore të të folurit, duke theksuar se dikur namatisjet „përfshinin një fushë më të gjerë se mjekësia e sotme”, duke përfshirë edhe „dashurinë, pasurinë, mbrojtjen nga dëmtuesit dhe fenomenet e natyrës, gjuetinë dhe luftën”. Në lëmin e „shëndetit” në namatisje hynin edhe njohuritë praktike të mjekimit, si dhe veprimi psikologjik të sëmurit. Namatisjet u përcilleshin të rinjve kryesisht me gojë; shqiptoheshin në një mënyrë specifike, të qetë dhe ritmike, nëpërmjet një organizimi të veçantë të të folurit të përshtatshëm për këtë lloj, edhe pse nuk bëhej organizimi ritmik për arsye dhe motive poetike. Ndërkaq, për nga karakteristikat e veta të brendshme, ato nuk janë lutje, por më tepër i takojnë magjisë. Në mënyrë të veçantë fjala është për elementet e vetë namatisjes: për kohën në të cilën bëhet ajo, për vendin, për sendet me të cilat bëhet namatisja, për sjelljen e pjesëmarrësve gjatë namatisjes, ku autori ka treguar një njohje të shkëlqyeshme të namatisjes, jo vetëm të ne por edhe më gjerë, duke cekur shembujt nga tradita e popujve evropianë; pastaj kur flet për rregullat e namatisjes, për bartjen e namatisjeve, për qëndrimin e treguesit ndaj namatisjes (i njëjti tekst për të gjitha llojet e sëmundjeve, të ndryshme për çdo lloj, improvizimi), për klasifikimin e namatisjeve (sipas qenieve satanike, njerëzve me sy të keq dhe njerëzve me fjalë të rrezikshme), për mbrojtjen preventive nga magjia, për klisjet e namatisjeve, për komplekset e shumta të caktuara si karakteristikë universale të traditës së namatisjes së popujve indoeuropianë (veçanësisht për numrin 3, 9 dhe 7) ose kur flet për parimet e magjisë së imitimit dhe parimin e barazimit të pjesës me tërësinë, nga i cili del edhe mënyra e namatisjes (individuale, përkatësisht monologjike dhe dialogjike). Në mënyrë të veçantë bëhet fjalë për raportin e literaturës së shkruar

dhe namatisjet popullore, ku autori vë në dukje ndikimet e teksteve apokrifje dhe të krishtërimit, pastaj edhe bartjen e namatisjeve nga një mjedis në tjetrin, madje edhe në mjediset e ndryshme gjuhësore, që autori i quan huazime.

Namatisjet ndahen në disa grupe: kundër zënies së gjarprit, kundër sëmundjeve ngjitëse, që janë më të shumtat, pastaj namatisjet e vajzërisë, mandej ato kundër fatkeqësive elementare, kundër dëmtuesëve dhe hajdutëve, dhe në fund ato të fëmijëve. Të gjitha namatisjet janë shënuar me numra rendorë prej 1—630, kurse nën secilën është shënuar thënia e shkurtër bibliografike e cila vë në dukje burimin që është dhënë i plotë në kaptinën *Bibliografia*, kështu që lexuesi mund të orientohet lehtë. Tekstet e namatisjeve janë marrë besnikërisht nga shënimet, kurse gjuha e tyre është dialektore, çka u jep një shije të veçantë. Ndryshimin që e ka bërë redaktori i botimit duke e dhënë tekstin e të folurit të lirë në formë të vargëzuar e ka bërë me të drejtë, sepse në shqiptimin e namatisjes ndihet synimi për organizimin e veçantë të gjuhës si mjet i shprehjes në mënyrë që të arrihet ritmika, pa marrë parasysh që krijuesi popullor, kur i ka krijuar, nuk ka pasur për qëllim të krijojë një gjuhë poetike, siç ka vepruar, për shembull, duke krijuar këngën popullore lirike. Krijimi i gjuhës së veçantë të namatisjes ka pasur për detyrë të krijojë një të folme të veçantë, rituale për nga karakteri i vet themelor i brendshëm. Pra, edhe pse krijuesi popullor, duke krijuar shembujt e këtij lloji të krijimeve popullore të të folurit nuk ka pasur detyrën e parashtruar që më parë që të shkaktojë përceptime dhe ndjenja estetike, ne, lexuesit e sotëm, megjithatë i përjetojmë edhe si tekst artistik, që më shumë shembuj të vet na përkujton poetikën bashkëkohore artistike ose të shkruar, sidomos të disa krijuesve. Fjalët në namatisje janë të zgjedhura dhe të renditura me kujdes në tërësi sintaktike dhe ritmike, të shprehura kryesisht me përsëritje, gjë që edhe për nga kjo veçori veçohen nga të gjitha krijimet e tjera popullore të të folurit dhe nga krijimtaria popullore shpirtërore në përgjithësi.

Struktura e namatisjes popullore zakonisht është e caktuar, sidomos kur është fjala për namatisjet kundër sëmundjes: së pari lutet sëmundja që të dalë nga i sëmuri, emri i të cilit patjetër përmendet, dhe dërgohet në vise të largëta; jo rrallë bëhet kërcënimi ndaj sëmundjes kundër së cilë bëhet namatisja, madje edhe me forca të tjera, që, sipas besimit popullor, janë më të forta se sëmundja. Besimi në aftësinë shëruese ose mbrojtëse të namatisjes, arkaizmi i madh i leksikut, stili i shprehjes, struktura e saj dhe disa karakteristika të tjera tregojnë se fjala është për një lloj shumë të vjetër të krijimeve popullore të të folurit, për një lloj që është ndryshuar shumë ngadalë dhe që i ka ruajtur mirë sidomos karakteristikat e veta të vjetra të stilit. Sugjestionimi i namatisjes të cilin e arrin me gjuhën dhe tërësitë e veta ritmike, që në të vërtetë janë formula të përcaktuara, pastaj të drejtuarit drejtpërdrejt sëmundjes, figurat e përcaktuara alegorike — i japin namatisjes, si lloj i krijimeve popullore të të folurit, një vlerë të caktuar literare dhe jep shije të caktuara si formë e vjetër e një lloji shumë të vjetër të krijimtarisë gojore. Megjithëse në namatisje është i shpeshtë toni i uratës, jo rrallëherë ajo ka formën e nëmës, të mallkimit, përbetimit dhe të lutjes, por kërcënimi është forma më e shpeshtë me të cilën i drejtohet, sidomos sëmundjeve.

Në kaptinën *Vërejtje dhe komente* Radenkoviqi jep një lëndë të begatshme dhe të vlefshme, shpeshherë, të domosdoshme për kuptimin e disa shembujve, madje edhe të një rrethi të tërë namatisjesh, si për shembull të *Gjarpri* (faqe 385—389), ku lexuesi gjen një gërshetim të tërë të dhënash mbi gjarprin si objekt i të besuarit të vjetër, e madje edhe të besuarit më të ri të krishten. Vihen në dukje edhe tekstet e caktuara, çka është prapë e lidhur me mjeshtëri me *Bibliografinë*, me anën e së cilës lexuesi mund të gjejë literaturën që i ofron sqarime më të gjera mbi këtë objekt. I tillë është rasti edhe me një varg elementesh të tjera të besimit që lidhen me shtrigën, përbindshin, fantazmën, kuçedrën, plakën, ankthin, ortekun etj. Këtu hujnë

edhe sqarimet lidhur me namatisjet kundër sëmundjeve të caktuara. Vërejtjet dhe komentet janë shtruar në një mënyrë të matur dhe të shkathtë, gjë që vërteton se autori i tyre është i informuar mirë mbi literaturën në të cilën diskutohet për këto probleme, veçanërisht kur është fjala për literaturën tonë dhe atë në gjuhën ruse.

*Bibliografia* vë në dukje burimet dhe studimet e namatisjeve si lloj të krijimeve popullore të të folurit. Ajo ndahet sipas sferave gjuhësore, kështu që së pari jepet literatura dhe burimet në gjuhën serbokroate, pastaj në atë maqedone, sllovene, bullgare, dhe në gjuhën e popujve sllavë të lindjes dhe në fund literatura nga gjuhët joslave. Numri më i madh i një-sive bibliografike është në gjuhën serbokroate (nga numri i përgjithshëm prej 665 sish, në gjuhën serbokroate janë 469). Punimet e cekura në *Bibliografi* ku nuk ka shembuj të namatisjeve Radenković i ka veçuar duke i shënuar me një yll, dhe kështu ka arritur tërësinë e çdo një-sie bibliografike dhe i është shman-gur dhënies së dyfishtë të një numri të madh një-sish bibliografike. Vëllimi i *Bibliografisë* gjithashtu dëshmon mbi informimin e mirë të autorit, si për burimet e namatisjeve në gjuhën serbokroate, ashtu edhe për literaturën që merret me studimin e tyre, jo vetëm te ne, por edhe në botë.

*Fjalori i fjalëve më pak të njohura* do t'i shërbejë lexuesit për kuptimin

e teksteve ndonjëherë jo mjaft të qarta, që në të vërtetë janë të paqarta për shkak të ndonjë fjale aty-këtu, qoftë ajo krahinore ose e huaj, por e përvetësuar në gjuhën e popullit, ose është e huaj dhe shumë e vjetër, kuptimin e së cilës sot nuk e kupton lexuesi bashkëkohor.

*Regjistri* përfshin emrat personale, por pranë tyre edhe fjalët, emrat e vlerave të shumta që paraqiten në namatisje. Ai do t'u shërbejë jo vetëm hulumtuesve, por edhe lexuesve kureshtarë në përgjithësi. Me fjalët në *Regjistër* vihet në dukje edhe numri i namatisjeve ku gjendet ajo fjalë, gjë që ka një rëndësi të veçantë.

Në fund të librit janë dhënë rezyemetë në gjuhën angleze dhe ruse, çka gjithashtu plotëson aparatën shkencor.

Thënë shkurtimisht: Ky është një libër i mirë dhe shumë i dobishëm për studimin e mëtejshëm të namatisjeve në gjuhën serbokroate, por edhe shembull se si mund të punohen librat me namatisje edhe në gjuhët e tjera, të cilat, sikur të ishin më shumë, do të kontribuonin në mënyrë konsiderueshme në hulumtimin krahasimtar të këtij lloji të krijimeve popullore të të folurit. Për një rreth të gjerë lexuesish tekstet e namatisjeve do të jenë lekturë interesante dhe do t'i zgjerojnë njohuritë mbi këtë lloj të kulturës së vjetër gojore popullore, por libri edhe si tërësi do të kontribuojë në shikimin e gjerë të trashëgimisë sonë gojore.

VLADIMIR BOVAN

**KËNGË DHE LOJËRA TË FËMIJËVE**, Instituti Albanologjik i Prishtinës, përgatitur nga Sadri Fetiu, Prishtinë 1983, f. 394.

Letërsia popullore, e cila, pos kënaqësisë shpirtërore, ka luajtur rol të rëndësishëm për edukimin, aftësimin dhe për ngritjen e vetëdijes artistike të shtresave të gjera, ka synuar të plotësojë nevojat e njerëzve të moshave të ndryshme brenda kufijve të mirësjelljes dhe të normave që respektoheshin në jetë. Kjo dëshmon se letërsia popullore gjatë trajtimit të problemeve është thelluar në sferat e ndryshme të jetës dhe të aktiviteteve njerëzore, varësisht nga interesimi

i moshës së brezit të cilit i është kushtuar.

Kufiri që i ndan krijimet e fëmijëve nga ato të të rriturve nuk është shumë rigoroz, ashtu si nuk janë rigorozë as ndarjet ndërmjet llojeve të kësaj poezie. Herë-herë kufiri ndërmjet llojeve të poezisë popullore është aq i njësuar sa vështirë gjenden elementet dominuese të njërit mbi tjetrin. Megjithatë, në bazë të disa elementeve dhe normave të kodifikuara rreth përcaktimit të gjinive dhe të